



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

KORRIGJIM VENDIMI

Datë 9.01.2024

“Mbi korrigjimin e gabimit material në numërtimin e Vendimit nr. 719, datë 9.11.2023 të Komisionit për subjektin e rivlerësimit z. Sokol Shehu”

Sot në datë 9.01.2024, trupi gjykues, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Genta Tafa (Bungo)	Anëtare
Suela Zhegu	Relatore

Bazuar në nenin 112 “Korrigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ” të Kodit të Procedurave Administrative, në të cilin përcaktohet se:

“1. Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.
2. Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij.”

Relatorja e trupit gjykues, pasi u vu në dijeni nga drejtori i menaxhimit të çështjeve dhe marrëdhënieve me median dhe publikun, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në të dhënat e regjistrat të çështjeve dhe të vendimeve, si dhe në e-mailin e dërguar të datës 9.11.2023 për të dhënat e vendimit të shpallur për subjektin Sokol Shehu (bashkëlidhur në format të printuar komunikimi me sekretarinë gjyqësore dhe këshilltaren ligjore të çështjes dt. 16.11.2023), konstatoi se:

Në vendimin përfundimtar të arsyetuar me shkrim e të njoftuar palëve, si dhe të versionit të publikuar në website-in zyrtar *kpk.al*, numri i vendimit të subjektit të rivlerësimit Sokol Shehu <https://kpk.al/z-sokol-shehu-gjyqtar-prane-gjykates-se-shkalles-se-pare-te-juridiksionit-te-pergjithshem-shkoder/30/> i përket numrit të vendimit të subjektit të rivlerësimit znj. Pranvera Gruda <https://kpk.al/znj-pranvera-gruda-prokurore-ne-prokurorine-prane-gjykates-se-apelitet-juridiksionit-te-pergjithshem-tirane/07/> dhe duhet të korrigjohet, në përputhje me të me arsyetimin si vijon:

Duke qenë se në Regjistrin e Çështjeve dhe të Vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vendimi me nr. 719, datë 24.11.2023, i përket subjektit të rivlerësimit Pranvera Gruda, ndërsa vendimi me nr. 713, datë 9.11.2023, i përket subjektit të rivlerësimit Sokol Shehu, nevojitet të bëhet korrigjimi i numërtimit sipas të dhënave në regjistrë.

Adresa: Rruga e Kavajës, ish - godina e “Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve”, Tiranë, *kpk.al*

Trupi gjykues pasi vlerësoi se kërkesa e relatores znj. Suela Zhegu qëndron dhe pasaktësitë janë vendosur dukshëm si pasojë e gabimit material,

V E N D O S I:

1. Korrigjimin e të dhënave të numrit të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Sokol Shehu “*Nr. 719 Vendimi*” dhe zëvendësimin me “*Nr. 713 Vendimi*”.
2. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit, Komisionerin Publik, dhe Vëzhguesin Ndërkombëtar për këtë korrigjim vendimi.
3. Vendimi i korrigjuar të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

TRUPI GJYKUES

Roland Ilia

Kryesues

Genta Tafa (Bungo)

Anëtare

Suela Zhegu

Relatore



Sekretare gjyqesore
Etmonda Hoxha